



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 22 shtator 2009, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C - 203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Selvije Halimi dhe Mufera Sinik- anëtarë .

Munguan: Adem Hajdaraj, Armend Zemaj dhe Vladimir Todoroviq.

Të pranishëm: Lumnije Murati- ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Besnik Boletini – Bota Sot, Assi Malavev, Rrezarta Ahmeti – KDI, Reshit Gashi - NDI dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10 shtatorit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për hetimin parlamentar;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Kryetari i Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i përshëndeti të pranishmit dhe ata që e mbikëqyrin punën e Komisionit dhe propozoi të fillohet me rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10 shtatorit 2009
Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Shqyrtimi i Projektligjit për hetimin parlamentar

Kryetari - I njoftoi se janë inkorporuar edhe propozimet dhe sugjerimet e dala nga dëgjimi publik dhe rekomandimet e ekspertit, prandaj me vërejtjet dhe sugjerimet që do t'i inkorporojmë tani e përcjellim për lexim të parë. Prandaj lidhur me këtë pikë hapi debat.

Bajram Kosumi- Duke iu referuar Projektligjit për hetimin parlamentar dha propozime, si vijon: neni 2.1 propozoi t'i shtohet “, në pajtim me Kushtetutën “, neni 2.3, në vend të fjalës “përcaktimit” të jetë “konstatimit”, neni 2.6 të kalojë te neni 4 dhe t'i shtohet një paragraf i ri dhe bëhet neni 4.5, në nenin 4.1 në vend të lidhëzës “ose “ të jetë “dhe”, ndërsa neni 12.4 propozoi të hiqet, kurse neni 13.1.b t'i shtohet fjala “ dhe Juridik “.

Adem Salihaj- Tha se neni 12.4 duhet të ndryshohet, sepse po qe se opozita e hap një çështje për hetim, që prek pozitën, logjikisht del se pozita me bojkotim e bllokon punën e Komisionit. Propozoi që në një nen të veçantë të parashihet mundësia e bojkotit të Komisionit.

Kryetari - Propozoi që neni 12.4 të ndryshohet si vijon: nëse një anëtar i një grupi parlamentar nuk merr pjesë 3 herë radhazi pa arsye, Komisioni kërkon nga Kuvendi që ky anëtar të zëvendësohet, jo detyrimisht nga i njëjti grup parlamentar, kurse neni 13. 1.g të hiqet.

Ibrahim Makolli - Theksoi se nëse hetohet opozita duhet të jetë një anëtar më shumë në Komision nga pozita. Në këtë mënyrë nuk do të bllokohej puna e Komisionit, por nëse thuhet “mungesa pa arsye”, lihet një hapësirë, sepse arsye mund të gjenden dhe kështu bllokohet puna e Komisionit.

Bajram Kosumi - Propozoi t'i shtohet një paragraf i ri neni 19.1 “Komisioni harton listën e dëshmitarëve”, ndërsa neni 19.1 bëhet 19.2 me riformulimin “ Lista e dëshmitarëve mund të azhurnohet deri në fazën e mbylljes së hetimeve”. Neni 19.2 bëhet neni 19.3 “Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të propozojë të ftohet një dëshmitar dhe Komisioni e merr parasysh gjithmonë”.

Ibrahim Makolli - Ngriti çështjen çka bëhet nëse paraqitet dëshmitari pas mbylljes së listës, që me dëshminë e tij mund ta ndryshojë rrjedhën e punës së Komisionit? Shtoi se mbyllja e listës së dëshmitarëve do ta kufizonte Komisionin në punën e tij.

Bajram Kosumi dhe Adem Salihaj - Ishin të mendimit që neni 19.3 të riformulohet si vijon “ Komisioni edhe gjatë fazës së mbylljes së hetimeve, kur konsideron se dëshmia e dëshmitarit mund ta ndryshojë thelbësisht rrjedhën e procesit, mund të vendosë të dëgjohet edhe në fazën e përfundimit”.

Ramadan Gashi - Propozoi që në nenin 12.2 fjalja “*përveç rasteve kur me këtë ligj parashihet ndryshe*”, të hiqet.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në Projektligj, aty ku është “Kryesia”, të zëvendësohet me “*Kryetari i Kuvendit*”.

Adem Salihaj - Propozoi që në nenin 10.1, në vend të fjalës “ grupit më të madh”, të jetë “*njërit grup parlamentar*”.

Kryetari - Propozoi që neni 9.4 të ndryshohet ” *Anëtarët e larguar të Komisionit duhen të zëvendësohen nga grupimi politik që ata përfaqësojnë, përveç rasteve kur konstatohet se anëtari pa arsye pengon punën e Komisionit*”.

Pas një diskutimi ishte konstatim i përgjithshëm që Projektligji për hetimin parlamentar, me plotësimet e inkorporuara, të përcillet për lexim të parë në një nga mbledhjet e radhës të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për dhënien e dekoratave nga kryetari i Republikës së Kosovës

Kryetari në emër të nënkomisionit i paraqiti amendamentet e propozuara lidhur me Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Kryetari i Republikës së Kosovës, preambula, nenet 1, 4,5, 23,24, 25,27,28 dhe 36.

Komisioni miratoi amendamentet me ndryshimet që në amendamentin 5, neni 23 dhe në amendamentin 7, neni 25, në vend të fjalës “*iniciativën* “ të jetë “ *nismën*”, ndërsa në amendamentin 3, nenet 4 dhe 5 mbeten si në Projektligj.

Bajram Kosumi - Duke iu referuar nenit 5 të Projektligjit, ishte i mendimit që emërtimi i dekoratave të bëhet me emra të përgjithshëm.

Adem Salihaj - Propozoi që neni 5, paragrafi 1.5, të bëhet neni 5, paragrafi 1. 6, ndërsa neni 5. paragrafi 1.6 bëhet neni 5 paragrafi 1.5 dhe të formulohet “ *Medalja e Artë për Liri, Pavarësi dhe Demokraci Dr. Ibrahim Rugova*”.

Komisioni me 4 vota kundër dhe me 2 abstenime, nuk e miratoi propozimin e Adem Salihajt.

5. Të ndryshme.

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të Projektligjit për turizmin dhe për shërbimet turistike dhe vlerësoi se Projektligji ka bazë juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Procesverbalin e hartoi
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni